

20160391006

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARINË FILMIKE**

Neni 1

Në Ligjin për veprimtarinë filmike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13, 18/14, 44/14, 129/15 dhe 152/15), në nenin 15 paragrafi (5) pika 5) në alinenë 4 presja zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Në alinenë 5 lidhësja "ose" zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Alineja 6 shlyhet.

Neni 2

Në nenin 26 pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijon:

"(3) Personi i autorizuar zyrtar në Agjencinë i cili e mban procedurën është i obliguar në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, me detyrë zyrtare ta sigurojë dëshminë për plotësimin e kushtit nga paragrafi (2) alineja 1 të këtij neni nga organi kompetent publik.

(4) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili është kërkuar dëshmia nga paragrafi (2) alineja 1 të këtij neni, është i obliguar të njëjtin ta dorëzojë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës."

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

Neni 3

Në nenin 48 pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijon:

"(2) Personi i autorizuar zyrtar në Agjencinë i cili e mban procedurën është i obliguar në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni, me detyrë zyrtare ta sigurojë dëshminë për plotësimin e kushtit nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni nga organi kompetent publik.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili është kërkuar dëshmia nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni, është i obliguar të njëjtin ta dorëzojë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës."

Paragrafët (2), (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6)

Neni 4

Në nenin 53 pas paragrafit (6) shtohet paragrafi i ri (7), si vijon:

"(7) Kundër aktvendimit nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni, kërkuuesi i mjeteve në bazë të kthimit të mjeteve nga neni 47 të këtij ligji ka të drejtë për ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Komisioni për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë."

Neni 5

Në nenin 56 pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijon:

"(3) Gjobë në lartësi prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar në Agjenci nëse nuk e kërkon dëshminë për detyrë zyrtare në afatin e përcaktuar në nenin 26 paragrafi (3) dhe neni 48 paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga Organi Kompetent publik nga i cili është kërkuar dëshmia, nëse nuk e dorëzon të njëjtin në afatet e përcaktuar në nenin 26 paragrafi (4) dhe neni 48 paragrafi (3) të këtij ligji."

Neni 6

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Neni 7

Dispozitat nga nenet 2, 3, 4, dhe 5 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".